



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 156/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr.REF-47078-01-06-2020, me objekt: *“Riparim mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza””* Loti I, me fond limit 17.383.344 lekë pa T.V.SH, zhvilluar ne daten 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Altec” sh.p.k ne procedurën e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Superior Klima” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k
Rruga “Muhamet Gjolllesha”, Nr.71/3, Kati I, Tiranë

“Altec” sh.p.k
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”, P.240/1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skenderbej, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.01.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit me Nr.REF-47078-01-06-2020, me objekt: “*Riparim mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*” Loti I, me fond limit 17.383.344 lekë pa T.V.SH, zhvilluar ne daten 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 18.02.2020 operatorët ekonomikë ankimues janë njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tyre nga procedura e mësipërme e prokurimit si më poshtë vijon:

“Sulollari Klima” sh.p.k	9.470.000,00 lekë, skualifikuar
“Superior Klima” sh.p.k	11.661.840,00 lekë, kualifikuar
“Altec” sh.p.k	12.118.667,30 lekë, skualifikuar
“Nika” sh.p.k	13.729.857,00 lekë, skualifikuar
“Climacasa” sh.p.k	14.778.368,00 lekë, skualifikuar
“Meni” sh.p.k	16.033.238,00 lekë, skualifikuar

BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k është skualifikuar me argumentat:

“Anëtari i BOE “Erxhen” Shpk nuk përmbush nënpikën 4, të pikës 3.1 Kapaciteti Ligjor/Profesional i operatorëve ekonomikë, pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatën ISO 14001, që konfirmon sistemin e menaxhimit të mjedisit.

• Anëtari i BOE “SULOLLARI-KLIMA” Shpk nuk arriti të përmbushë nënpikën 1 të pikës 3.1 Kapaciteti Ligjor/Profesional i operatorëve ekonomikë, pasi licenca nr. 4360/7 datë 28.04.2015, e dorëzuar në mënyrë elektronike, nuk përmban NS-2A Impjante hidrosanitare, kuzhinë, lavanteri, mirmbajtja e tyre e kërkuar në kriterin e mësipërm”.

“Altec” sh.p.k është skualifikuar me argumentat:

“Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nënpikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër. ”

II.3. Në datën 21.02.2020, BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, me anë të së cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Se pari: Ju kerkoni ne KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT:

3. Kandidatiloftuesi duhet te dorezoje:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

2. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

3. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

4. Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te mjedistit ISO 14001 (e vlefshme). Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas aktmarreveshjes.

Ne lidhje me kete kriter ne si BOE kemi dorezuar:

-Sulollari-Klima Shpk: ISO 9001:2015 (e vlefshme), OHSAS 18001 (e vlefshme), ISO 14001(e vlefshme)

-Erxhen Shpk: ISO 9001:2015 (e vlefshme) , ISO 45001 (e vlefshme)

Pra po ju kujtojme se ne jemi nje bashkim operatoresh ekomomik dhe sipas VKM-se Nr. 914, date 29.12.2014 PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATE 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATE 23.11.2016 DHE ME VENDIMIN NR. 797, DATE 29.12.2017

Neni 74

Bashkimi i operatoreve ekonomike

1. Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushë kërkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Duke iu referuar dhe marreveshjes se bashkepunimit ne perqindjen e pjesemarrjes te seciles shoqeri me nje llogari te thjeshte Erxhen Shpk (54%) ploteson dy ISO dhe Sulollari-Klima Shpk (46%) ploteson nje ISO.

Ky skualifikim eshte ne kundershtrim te hapur me ligjin. Ju lutem beni ndryshimet perkatese duke kualifikuar BOE "Sulollari-Klima" shpk dhe "Erxhen" shpk.

Se Dyti: Ju kerkoni

Ne KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT

3. Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

1. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me license profesionale qe lidhen me realizimin e sherbimeve objekt prokurimit, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetore, per kategorite:

- NS12-A Impianti tecnologjik, termike dhe te kondicionimit*
- NS-2A Impianti hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.*

Ne lidhje me kete kriter ne si BOE kemi dorezuar :

Liscencen m.4360/7 date 28.04.2015-e shoqerise" Sulollari-Klima" Shpk e cila ka piken

- NS12-A Impianti tecnologjik, termike dhe te kondicionimit*

Dhe licenca tjeter eshte licenca NZ.1771/9 ,date 03.04.2019 -e shoqerise "Erxhen" Shpk e cila nder te tjera ka dhe

- NS-2A Impianti hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.*

Po ju kujtojme edhe njehere se ne jemi nje bashkim operatoresh ekomomik dhe sipas VKM-se Nr. 914, date 29.12.2014 PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 402, DATE 13.05.2015, ME VENDIMIN NR. 823, DATE 23.11.2016 DHE ME VENDIMIN NR. 797, DATE 29.12.2017

Neni74

Bashkimi i operatoreve ekonomike

1. Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushë kërkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Pra sipas nenit me siper meqe jemi BOE

-Nje pike te kesaj kerkese e ploteson Sulollari-Klima Shpk pra NS-12 - A, dhe piken tjeter NS-2 A e ploteson shoqeria "Erxhen" shpk .(Te dyja licencat i keni bashkangjitur kesaj ankese).

Duke u bazuar tek ligji me siper ne e kundershtojme kete refuzim.

Si perfundim, bazuar ne arsyetimin dhe argumentat e parashtruara sa mesiper, shoqeria jone kerkon rivleresimin e kesaj procedure prokurimi, duke e kualifikuar BOE- "Sulollari-Klima " Sh.p.k., dhe Erxhen Shpk per lotin 1.

II.4.1. N p rmjet shkres s nr. 310/3 prot., dat  25.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer p rgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankes n si vijon:

"Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi BOE "Sulollari Klima" SHPK dhe "Erxhen" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 4 ne seksionin 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, shtojca 8, BOE "Sulollari-Klima" SHPK dhe "Erxhen" SHPK ka dorezuar dokumentacionin me emertim: "Iso _14001 2015 _ Sulollari-Klima_ 19."

Ne kriterin e percaktuar ne piken 4 ne seksion 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", Shtojca 8, percaktohet se: " Operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate qe verteton cilesine e menaxhimit te mjedistit ISO 14001 (e vlefshme). Certificate te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise."

Ne Akt marreveshjen "Marreveshje Bashkim Operatoresh", te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik me nr. 292 REP/ 127 KOL date 25.01.2020, ndermjet "Sulollari-Klima" SHPK dhe "Erxhen" SHPK rezulton se masat ne te cilet shoqerite do te kryejne punime jane 46 % shoqeria "Sulollari-Klima" SHPK dhe 54% shoqeria "Erxhen" SHPK. Ne akt marreveshje eshte percaktuar se secili nga operatoret do te vere ne dipozicion pika te licences, inxhinierëve te kerkuar, te kriterëve teknike dhe kryerjen e punimeve te preventivit ne baze te preventivit dhe volumit te punes bashkengjitur marreveshjes. Ne marreveshje bashkengjitur eshte tabela permbledhese "te sherbimeve qe do te kryhen nga ky bashkim operatoresh" pjese te sherbimit, punes ose furnizimit qe do te realizoje secili operator ekonomik.

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Erxhen" SHPK nuk ka dorezuar, certificate qe verteton cilesine e menaxhimit te mjedistit ISO 14001 (e vlefshme), pra ofertuesi nuk e permbushin kriterin e percaktuar Shtojcen nr. 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", Seksioni 3.1 'Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike", pika 4.

Sqarojme se ne baze te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" e ndryshuar, neni 74 pika 3 percaktohet: "Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushë kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike/ financiare/profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune sherbim apo furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje".

Bazuar ne ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 53 pike 3 " Organi Qendror Bleres ka bere skualifikimin e BOE "Sulollari-Klima" Shpk dhe "Erxhen" SHPK.

Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Sulollari-Klima" SHPK nuk pranohet.

2. Ofertuesi BOE "Sulollari-Klima" Shpk dhe "Erxhen" SHPK ka ankimuar skualifikimin per mospermbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen nr.8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pika 1, ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me license profesionale qe lidhen me realizimin e sherbimeve objekt prokurimit, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetore, per kategorie: -NS 12-A Impiante teknologjik, termike dhe ti kondicionimit. - NS-2A Impiante hidro-sanitare. kuzhina. lavanteri, mirembajtja e tyre. Me pretendimin si vijon: [...] " Ne lidhje me kete kriter ne si BOE kemi dorezuar: Licencen nr.4360/7 date 28.04.2015-e shoqerise " Sulollari-KLima shpk e cila ka piken "NS12-A Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit , dhe licenca tjeter eshte licenca NZ.1771/9, date 03.04.2019 e shoqerise "Erxhen" Shpk e cila nder te tjera ka dhe "NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Pra po ju kujtojme se ne jemi nje bashkim operatoresh ekonomik dhe sipas VKM-se Nr. 91-1. date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik ", i ndryshuar me vendimin nr. 402, date 13.05.2015, me vendimit nr. 823, dare 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797. date 29.12.2017, Neni 74 "Bashkimi i operaforeve ekonomik": "Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbush kerkesesat ligjore te parashikuaar ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Kerketat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne furnizim sherbim apo pune te percaktuara ne akt marreveshje. " Pra sipas nenit me siper meqe jemi BOE, nje pike te kesaj kerkese e ploteson Sulollari -Klima sh.p.k pra NS-12-A, dhe piken tjeter NS-2A e ploteson shoqeria "Erxhen" shpk. (Te dyja licensat i keni bashkangjitur kesaj ankese). Duke u bazuar tek ligji me siper ne e kundershtojme kete refuzim. Si perfundim. bazuar ne arsyetimin dhe argumentat e parashtruara sa me siper shoqeria jone kerkon rivleresimin e kesaj procedure prokurimi, duke e kualifikuar BOE "Sulollari- Klima shpk dhe "Erxhen " Shpk per lotin 1."

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi BOE "Sulollari-Klima" shpk dhe "Erxhen" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin BOE "Sulollari-Klima" SHPK dhe "Erxhen" SHPK, Komisioni i Vleresimit tc Ofertave ka njoftuar automatikisht dhe dhene nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 18.02.2020, arsyet e skualifikimin te tij si vijon: "Anetari i BOE "SULOLLARJ-KUMA" Shpk nuk arriti te permbush nenpiken 1 te pikes 3. Kapaciteti Ligjor/Profesional i operatoreve ekonomike, pasi licenca nr.4360/7 date 28. 04.2015, e dorezuar ne menyre elektronike, nuk permban NS-2.4 Impjante hidrosanitare, kuzhine. lavanteri. mirembajtja e tyre e kerkuar ne kriterin e mesiperm ,.

Komisioni i Shyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga ofertuesi BOE "Sulollari Klima" SHPK dhe "Ershen" SHPK e konstatoi:

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 1 në seksionin 3.1 "Kapaciteti i ligjor/profesional i operatorëve ekonomik" në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 8, BOE "Sulollari-Klima" SHPK dhe "Ershen" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin me emërtim: "Licenca_NS_2 dhe NS12_Ershen", "Licenca_NS/2_Sulollari".

Në kriterin e përcaktuar në pikën 1 në seksion 3.1 "Kapaciteti i ligjor/profesional i operatorëve ekonomik" në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", Shtojca 8, përcaktohet se: "Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë: NS12-A Impianti teknologjik, termike dhe të kondicionimit dhe NS-2A Impianti hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre."

Në Akt marrëveshjen "Marrëveshje Bashkim Operatorësh", të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, me nr. 292 REP/ 127 KOL datë 25.01.2020, ndërmjet "Sulollari-Klima" SHPK dhe "Ershen" SHPK rezultoi se masat në të cilat shoqëritë do të kryejnë punime janë 46 % Shoqëria "Sulollari-Klima" SHPK dhe 54% shoqëria "Ershen" SHPK. Në akt marrëveshje është përcaktuar se secili nga operatorët do të vë në dispozicion pika të licencës, inxhinierëve të kërkuar, të kriterëve teknikë dhe kryerjen e punimeve të preventivit në bazë të preventivit dhe volumit të punës bashkëngjitur marrëveshjes. Në marrëveshje bashkëngjitur është tabelë përmbledhëse "të shërbimeve që do të kryhen nga ky bashkim operatorësh" pjesë të shërbimit, punës ose furnizimit që do të realizojë secili operator ekonomik.

Nga verifikimi i licencës së dorëzuar për ofertuesin "Sulollari-Klima" SHPK, rezultoi se kategoritë për licencën NZ.4360/7 janë NP-12, NS-3, NS-5, NS-6, NS-7, NSD-12 dhe NS-14. Mëson kategorinë NS-2 A. Për ofertuesin nuk është përmbushur kriterin e përcaktuar Shtojcën nr. 8 në "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", seksioni 3.1 "Kapaciteti i ligjor/profesional i operatorëve ekonomik:", pika 1."

II.4.2. Në datën 04.03.2020 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 24.02.2020, operatori ekonomik ankimes "Altec" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

" [...]

Në, operatori ekonomik ALTEC shpk jemi skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me arsyen: "Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ në pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuader". Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezultoi se nga ana e autoritetit kontraktor në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti teknik pika 3.3.3 është parashikuar konkretisht si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise, person pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader, i cili dultet te jete ne profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil dhe per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

- diplome
- kontrata pune te vlefshme
- libreze pune

Bazuar ne kriterin e sa me siper cituar ne nenpiken 3 te pikes 3.3 te kapaciteteve teknike te dokumentave standarte te tenderit ne si operator ekonomik "ALTEC" shpk ne permbushje te kriterit te sa me sipercituar kemi ngarkuar ne SPE ne menyre rigoroze dokumentat teknike perkatesisht, skedaret perkates te inxhinierit elektrik z. E. M me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil, i cili eshte drejtues teknik prane shoqerise tone, dhe do te jete pergjegjes per kryerjen e sherbimeve ne Lotin 1 objekt i kesaj procedure prokurimi, i cilesuar kjo edhe nepermjete deklarates se paraqitur nga ana jone.

Per punonjesin me profesione si me siper, jane paraqitur dokumentat e kerkuara ne nenpiken 3 te pikes 3.3, perkatesisht:

Diplome

Kontrate pune

Libreze pune

Deklaraten e administratorit te shoqerise i cili cakton si person pergjegjes per lotin 1 pikerisht inxhinierin mekanik z. E. M.

Si dhe licensa ku vertetohet eksperienca e tij shumevjecare.

Listpagesat e shoqerise.

Persa me siper gjykojme se pretendimet e autoritetit kontraktor ne lidhje me skualifikimin tone nuk qendrojne dhe jane ne kundersiztim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues te dokumentave te tenderit, ne si shoqeri kemi paraqitur dokumentacionin e duhur ne lidhje me disponueshmerine e nje inxhinier elektrik/inxhinier mekanik me eksperience pune jo me pak se 1(nje) vit ne kete profil.

Operatori ekonomik Superior Klima Klima gjithashtu nuk ploteson kriterin se: "Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise, person pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader, i cili duhet te jete ne profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil". Ky operator duhet te qendroje i skualifikuar pasi ne kundersiztim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues te dokumentave te tenderit, pasi inxhinieri elektrik/mekanik nuk figurojne ne listepagesat e periudhes Shtator 2019 - Nentor 2019. Pasi referuar VKM nr. 514, date 20.9.2017 "Per miratimin e Listes Kombetare te Profesioneve (LKP)", te rishikuar., kodi nr 2144 "Inxhinier Mekanik" ose kodi nr. 2144.16 i cili referohet profesionit "Inxhinier Mekanik per ngrohje-ventilim-ftohje" profil ky qe perkon edhe me objektin e prokurimit, si dhe kodi 2151 "Inxhinieri elektrike", kode keto te cilat perkojne me kerkesat e autoritetit kontraktor ne dokumentat standarte te tenderit, kapaciteti teknik ku autoriteti kontraktor ka kerkuar 1 (nje) Inxhinier Mekanik dhe 1 (nje) inxhinier Elektrik, ne si operatore ekonomik na lind

e drejta te dyshojme se ne listpagesat e firmes Superior Klima Klima nuk figurojne inxhinieret e deklaruar prej saj pra ing Mekanik/Elektrik sipas kodeve perkatese te parashikuar ne VKM nr. 514, date 20.9.2017 "Per miratimin e Listes Kombetare te Profesioneve (LKP)", te rishikuar. Pra nga sa me siper ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentet per 1 (nje) Inxhinier Mekanik/Inxhinier Elektrik ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST. Kjo shoqeri nuk ka plotesuar kriterin kualifikues te DST pasi nuk ka te siguruar ne liste pagesat e periudhes Shtator 2019 - Nentor 2019 inxhinierin elektrik/mekanik sipas VKM nr 514, date 20.09.2017 "Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP) e rishikuar", Pasi kemi te bejme me nje kod specifik i cili i perket nje profesioni specifik dhe kesisoj nuk mund te pranohet kodi i nje profesioni tjeter per punonjesit e deklaruar. Edhe sikur pretendimi i operatorit ekonomik ne lidhje me padijenine ligjore ne lidhje me kete VKM jane te papranueshme, pasi njohja apo mosnjohja e ligjit eshte pergjegjesi individuale e subjekteve qe marrin pjese ne nje marredhenie juridike.

Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet ta skualifikoje operatorin ekonomik Superior Klima pasi ky operator ekonomik nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST Shtojcen 4, Deklarate mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme, pasi nuk ka deklaruar se Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaraten nga administratori i shoqerise se cili nga inxh do te jete pergjegjes per kryerjen e sherbimeve ne proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe deklaraten nga administratori i shoqerise, se inxhinieret e mesiperm, jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera. Dyshojme se inxhinieret e deklaruar nga ky operator, jane te angazhuar edhe ne procedura te tjera.

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk disponon edhe Licensen profesionale per kategorine NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.

Nuk ka plotesuar deklaraten per paraqitje ofertes te pavarur, sipas Shtojces 1/1 si dhe Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme shtojcen 7.

Pra, i nderuar z. Kryetar i Autoritetit Kontraktor, vendimi i KVO- se, per skualifikimin e ofertes tone eshte i nxituar, i gabuar, dhe ne shkelje te plote me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.914, date 29.12.2014 i ndryshuar, rrjellimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj.

II.5.1. N p rmjet shkres s nr. 318/2 prot., dat  26.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer p rgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankes n vijon:

“ [...]

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Altec" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 4 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti reknik" ne "Kriteret

e Vecanta te kualifikimit" shtojca nr. 8 ka dorezuar dokumentacionin me emertim "deklarate per drejtuesin teknik". Ne kete dokumentacion, Z. Arben Aliaj ne cilesine e administratorit te shoqerise "Altec" SHPK ka deklaruar se ne tenderin Lotin 1, "Riparim, mirembaje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza", drejtues teknik i shoqerise do te jete Z. E.M. Ne dokumentacionin e sipercituar dhe ne dokumentacionin me emertim "ing_Mekanik_Ektrik_Manushi", pjese jane dhe libreza e punes, kontrata dhe diploma. CV per Z.E.M.

Sqarojme se kerkesa per personin pergjegjes per kryeijen e sherbimeve objekt i marreveshjes kuader ne Lotin 1, i korrespondon pika 4, ne seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca Nr.8 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise, personin pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader, i cili duhet te jete ne profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil", dhe jo pika 3 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti Teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit".

Ne shtojcen nr 8 ne dokumentat e tenderit eshte bere shenimi se, Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per me teper se nje Lot, duhet te kene kapacitetet ekonomike-financiare (pika 3.2 nenpika 1) e kriterëve te vecanta per kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 3.3 e kriterëve te vecanta per kualifikim) sa shuma e loteve, per te cilat kane ofertuar, te marra se bashku. Nga veri fikimi rezulton sc ofertuesi "Altec" SHPK ka ofertuar ne 2 Lote per kete procedure prokurimi, konkretisht Loti I me objekt: "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza" dhe Loti II me objekt: "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni".

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ne permbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen nr. 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 3, ne dokumentet e tenderit, ofertuesi "Altec" SHPK ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Deklarate_per_drejtuesin_teknik". Ne kete dokumentacion, Z. Arben Aliaj ne cilesine e administratorit te shoqerise "Altec" SHPK ka deklaruar se ne tenderin Lotin II "Riparim-mirembajtje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni", drejtues teknik i shoqerise do te jete Z. A.H. Ne dokumentacionin me emertim "ing_elektrik_Agim_Hasani", pjese jane dhe libreza e punes, kontrata dhe diploma, licensa, CV per personin e sipercituar.

Dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi "Altec" SHPK per dy lotet ne te cilat ky ofertues ka ofertuar me konkretisht per Loti I me objekt "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza" dhe Loti II me objekt "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni" ploteson kriterin komulativ, per punonjesit e kerkuar ne piken 3 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca 8 ne dokumentat e tenderit ne Lotin II dhe punonjesit e kerkuar ne piken 4 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca 8 ne Lotin I.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK pranohet.

2. [...]

Per ofertuesin "Superior Klima" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 18.01.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ne permbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen nr. 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 3, ne dokumentet e tenderit, ofertuesi "Altec" SHPK ka dorezuar dokumentacionin me emertim,

"Ing_mekanik "A.Z" dhe "Ing_Elektrik_A.M". Pjese e dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik jane dhe diplomat, kontratat e punes dhe librezat e punes. Ne listepagesat e dorezuar per periudhen Shtator 2019- Nentor 2019, figurojne dhe punonjesit e siperccituar konkretisht Z.A.Z dhe A.M, pra ofertuesi e ka permbushur kriterin e percaktuar ne dokumentat standarde te tenderit.

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ofertuesi te kriterit e percaktuar ne Shtojcen nr. 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 4 ne dokumentat e tenderit ka dorezuar dokumentacionin me emertim "deklarat_mbi_personin _pergjegjes _mbi zbatimin _e_kontates". Ne kete dokumentacion, Z. A.M ne cilesine e administratorit te shoqerise "Superior Klima" SHPK ka deklaruar se ne tenderin Lotin I "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza", personi pergjegjes i shoqerise per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader do te jete Z.A.F. Per personin pergjegjes jane dorezuar dhe dokumentat diplorne, kontrate pune dhe libreze pune ne perputhje me kerkesar e dokumentave te tenderit.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK nuk pranohet.

3. Ofertuesi "Altec" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Superior Klima" SHPK per mospermbushje ne formatin e kerkuar te shtojces "Deklarate mbi Permbushjen e Kritereve te Pergjithshme".

Me pretendimin si vijon: [.. .]" ... Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet ta skualifikoje operatorin ekonomik "Superior Klima" pasi ky operator ekonomik nuk ploteson kerkesen e dhene ne DST Shtojcen 4, Deklarate mbi permbushjen e kritereve te përgjithshme, pasi nuk ka deklaruar se Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Altec" SHPK, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin "Superior Klima" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 18.01.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ka dorezuar dokumentacion me emerim "Shtojca_7 _Deklate_permbushjen_e_kritereve_te_pergjithshme". Pjese e ketij dokumentacioni eshte dhe "Deklarata mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme", e cila nga verifikimi i bere rezulton te jete ne perputhje me shtojcen 7 te percaktuar ne dokumentat e tenderit. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit "Altec" SHPK se ofertuesi nuk ka deklaruar Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, rezulton se ofertuesi "Superior Klima" SHPK ka bere plotesimin e emrave ne permbushje te shtojces 7 dhe qe perputhet me personat e deklaruar ne QKB. Sqarojme se ne ankese ofertuesi "Altec" SHPK i eshte referuar ne nje pjese te pretendimit te tij si shtojca 4. Ju informojme se ne shtojcen 4 eshte "Lista e Informacionit Konfidencial" dhe jo "Deklarata mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme" e cila percaktohet ne shtojcen 7 te dokumenteve te tenderit.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK nuk pranohet.

4. Ofertuesi "Altec" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesi "Superior Klima" SHPK per mospermbushje te pikes 1 te seksionit 3.1 "Kapaciteti ligjor/profcsional i operatoreve ekonomike" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" Shtojca Nr. 8 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me license profesionale qe lidhen me realizimin e sherbimeve objekt prokurimit, te leshuara nga autoritetet kompetente shieterore, per kategorite: NS/ 2-A Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit. NS-2A Impiante hidro sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. "

Me pretendimin si vijon: [.. .]"... Gjithashtu ky operator ekonotnik nuk disponon edhe License profesionale per kategorine NS- 2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina. Lavanteri, mirembajtja e tyre. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Altec" SHPK, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin "SuperiorKlima" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 18.01.2020, kualifikimni e tij. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sisternin e prokurimit elektronik, ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 1 ne seksionin 3. l "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve

ekonomik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca nr.8, ofertusi ka dorezuar dokumentacionin me emertimin "Licenca _ne _zbatim". Pjese e ketij dokumentacioni eshte Licenca NZ 68 l 0/6 e cila permban dhe kategorizimin sipas punimeve te zbatimit ne ndertim. Pra ofertuesi e ploteson kriterin e percaktuar Shtojcen nr 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike", pika 1.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK nuk pranohet.

5. Ofertuesi "Altec" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesi "Superior Klima" SHPK per mosploresim te shtojces 1/1 "Deklarate per paraqitjen e ofertes se pavarur",

Me pretendimin si vijon: "Nuk ka plotesuar deklaraten per paraqitje ofertes te pavarur, sipas Shiojces 1/1 DT dhe Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme shtojcen 7. Pra, i nderuar z. Kryetar i Autoritetit Kontraktor, vendimi i KVO- se, per skualifikimin e ofertes tone eshte i nxituar, i gabuar, dhe ne shkelje te plote me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 914. dale 29.12.2014 i ndryshuar, rrjedhimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana juaj. [...]"

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankesë mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Altec" SHPK, konstaton si me poshte:

Per ofertuesin "Superior Klima" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 18.01.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Superior Klima" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Shtojca_ 1 -1 _ Deklarate pcr paraqitje _oferte _te _pavarur. Pjese e dokumentacionit eshte Deklarata "Per paraqitje Oferte te Pavarur", qe eshte plotesuar nga ofertuesi "Superior Klima" ne perputhje me shtojcen 1/1 te percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK nuk pranohet.

II.5.2. Në datën 06.03.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 17.03.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 271/2 prot., informacioni e dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Ershen” sh.p.k se: *“Anëtar i BOE “SULLOLLARI-KLIMA” Shpk nuk arriti të përmbushë nën pikën 1 të pikës 3.1 Kapaciteti Ligjor/Profesional I operatorëve ekonomikë, pasi licenca nr. 4360/7 datë 28.04.2015, e dorëzuar në mënyrë elektronike, nuk përmban NS-2A Impjante hidrosanitare, kuzhinë, lavanteri, mirmbajtja e tyre e kërkuar në kriterin e mësipërm”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, pika 3.1.1 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”*, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:*
 - *NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit*
 - *NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se BOE ankimues *“Sulollari Klima” sh.p.k. & “Ershen” sh.p.k.*, për plotësimin e kriterit të mësipërm, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. *Kontratë për Bashkimin e Përkohëshëm të Shoqërive me Nr. Rep 297 dhe Nr. Kol 12, datë 25.01.2020.*
2. *Licence NZ. 4360/7 Sulollari.*
3. *Licence NZ. 1771/9 Ershen*

III.1.3. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* b) *“aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtui, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE “Sulollari - Klima” sh.p.k. & “Erxhen” sh.p.k, rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë për Bashkim të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Sulollari - Klima” sh.p.k. dhe shoqërisë “Erxhen” sh.p.k., nga ku shoqëria “Sulollari - Klima” sh.p.k merr përsipër të realizojë 46% të të kontratës objekt prokurimi për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza dhe shoqëria “Erxhen” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 54% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimes, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP vëren se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ky i fundit ka paraqitur Licencën NZ. 4360/7, lëshuar nga MTI, për operatorin ekonomik “Sulollari” sh.p.k., dhe Licencën NZ. 1771/9, lëshuar nga MTI, për operatorin ekonomik “Erxhen” sh.p.k. Në Licencën profesionale NZ. 4360/7, lëshuar nga MTI, për operatorin ekonomik “Sulollari” sh.p.k, konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Sulollari Klima” shpk nuk është i licencuar për kategorin “NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së

prokurimit objekt shqyrtimi. Operatori ekonomik “Sulollari Klima” shpk pjesëtarë i bashkimit të operatorëve ankimues nuk disponon licence për kryerjen e shërbimeve të kategorisë NS-2A, fakt ky i pranuar edhe nga vetë ankimuesi. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, “Sulollari Klima” shpk pjesë e BOE ankimues nuk disponon kategorinë e licencës për kryerjen e shërbimeve për kategorinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vendosur në shtojcën 8, pika 3.1.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.8. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë

20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit”.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Sulollari - Klima” sh.p.k. & “Erxhen” sh.p.k, nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik, referuar arsytimit të dhënë më sipër në pikën III.1. gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k nuk përmbush kriterin e veçantë të pranimit/kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike edhe pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të ndryshojë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Altec” sh.p.k se: “Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2, 3 dhe 4, të dokumentave të tenderit, është parashikuar si vijon:

2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për drejtimin e punimeve në përberjen e të cilit duhet të jete të paktën:

- 1 (nje) inxhinier mekanik

- 1 (nje) inxhinier elektrik

➤ Për punonjësit me profesione si më sipër duhet të paraqesi:

- Diplomë

- Kontratë pune

- Libreze pune

4. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik /inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

III.3.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit ankimesi pretendon si vijon: Operatori ekonomik ALTEC shpk jemi skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Perqendruara me arsyen: "Operatori ekonomik nuk përmbush Kriterin Komulativ nën pikën 3 të pikës 3.3 Kapaciteti Teknik për personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër". Referuar dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti teknik pika 3.3.3 është parashikuar konkretisht si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1 (një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtem:

- diplome
- kontrata punë të vlefshme
- libere punë

Bazuar në kriterin e sa më sipër cituar në nën-pikën 3 të pikës 3.3 të kapaciteteve teknike të dokumentave standarte të tenderit në si operator ekonomik "ALTEC" shpk në përmbushje të kriterit të sa më sipërcituar kemi ngarkuar në SPE në mënyrë rigoroze dokumentat teknike përkatësisht, skedarët përkatës të inxhinierit elektrik z. E. M me eksperiencë punë jo më pak se 1 (një) vit në këtë profil, i cili është drejtues teknik pranë shoqërisë tone, dhe do të jetë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në Lotin 1 objekt i kësaj procedure prokurimi, i cili është kjo edhe nëpërmjet deklaratës së paraqitur nga ana jone.

Për punonjës të profesione si më sipër, janë paraqitur dokumentat e kërkuara në nën-pikën 3 të pikës 3.3, përkatësisht:

Diplome

Kontrata punë

Libere punë

Deklaratën e administratorit të shoqërisë i cili cakton si person përgjegjës për lotin 1 përkohësisht inxhinierin mekanik z. E. M.

Si dhe licenca ku vertetohet eksperiencia e tij shumëvjeçare.

Listë e libërve të shoqërisë.

Për sa më sipër gjykojmë se pretendimet e autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin tone nuk qëndron dhe janë të eshtrë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit, në si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinier elektrik/inxhinier mekanik me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

III.3.3.Nëpërmjet shkresës nr. 318/2 prot, datë 26.02.2020 autoriteti kontraktor e pranon pretendimin e ankimesit me arsyetimin se:

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga ofertuesi "Altec" SHPK dhe konstatoi:

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ofertuesi ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 4 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti reknik" ne "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" shtojca nr.8 ka dorezuar dokumentacionin me emertim "deklarate per drejtuesin teknik". Ne kete dokumentacion, Z. Arben Aliaj ne cilesine e administratorit te shoqerise "Altec" SHPK ka deklaruar se ne tenderin Lotin I, "Riparim, mirembaje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza", drejtues teknik i shoqerise do te jete Z. E.M. Ne dokumentacionin e sipercituar dhe ne dokumentacionin me emertim "ing_Mekanik_Ektrik_Manushi", pjese jane dhe libreza e punes, kontrata dhe diploma. CV per Z.E.M.

Sqarojme se kerkesa per personin pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i marreveshjes kuader ne Lotin 1, i korrespondon pika 4, ne seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca Nr.8 ne dokumentat e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise, personin pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader, i cili duhet te jete ne profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil", dhe jo pika 3 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti Teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit".

Ne shtojcen nr 8 ne dokumentat e tenderit eshte bere shenimi se, Operatoret ekonomike qe do te ofertojne per me teper se nje Lot, duhet te kene kapacitetet ekonomike-financiare (pika 3.2 nenpika 1) e kriterëve te vecanta per kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 3.3 e kriterëve te vecanta per kualifikim) sa shuma e loteve, per te cilat kane ofertuar, te marra se bashku. Nga veri fikimi rezulton sc ofertuesi "Altec" SHPK ka ofertuar ne 2 Lote per kete procedure prokurimi, konkretisht Loti I me objekt: "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza" dhe Loti II me objekt: "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni".

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ne permbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen nr. 8 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 3, ne dokumentet e tenderit, ofertuesi "Altec" SHPK ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Deklarate_per_drejtuesin_teknik". Ne kete dokumentacion, Z. Arben Aliaj ne cilesine e administratorit te shoqerise "Altec" SHPK ka deklaruar se ne tenderin Lotin II "Riparim-mirembajtje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni", drejtues teknik i shoqerise do te jete Z. A.H. Ne dokumentacionin me emertim "ing_elektrik_Agim_Hasani", pjese jane dhe libreza e punes, kontrata dhe diploma, licensa, CV per personin e sipercituar.

Dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi "Altec" SHPK per dy lotet ne te cilat ky ofertues ka ofertuar me konkretisht per Loti I me objekt "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Qendren Spitalore Universitare "Nene Tereza" dhe Loti II me objekt "Riparim, mirembajtjeje sistemi te ngrohje-ftohjeve ne Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koco Gliozheni" ploteson kriterin komulativ, per punonjesit e kerkuar

ne piken 3 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca 8 ne dokumentat e tenderit ne Lotin II dhe punonjesit e kerkuar ne piken 4 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" shtojca 8 ne Lotin I.

Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Altec" SHPK pranohet.

III.3.4. Përsa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor i ka pranuar pretendimet e ankimuesit "Altec" sh.p.k përsa i përket skualifikimit të tij nga ana e KVO-së, duke e kualifikuar ankimuesin, ndaj këto pretendime nuk do të merret në shqyrtim në themel nga KPP, pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

Megjithatë nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pasqyruar këtë vendim të KSHA në sistemin elektronik, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Për këtë arsye AK duhet të pasqyrojë në SPE vendimin e KSHA lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ky i fundit për kualifikimin e operatorit ekonomik "Altec" sh.p.k.

III.4. Në kushtet kur operatorit ekonomik "Altec" sh.p.k i është pranuar ankesa nga KSHA, lidhur me skualifikimin e tij dhe autoriteti kontraktor duhet të pasqyrojë edhe në SPE kualifikimin e kësaj shoqërie, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të marrë në shqyrtim pretendimet e shoqërisë "Altec" sh.p.k për shoqërinë "Superior Klima" sh.p.k.

III.4.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Altec" sh.p.k se: "Operatori ekonomik Superior Klima Klima gjithashtu nuk ploteson kriterin se: "Operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise, person pergjegjes per kryerjen e sherbimeve objekt i kesaj marreveshje kuader, i cili duhet te jete ne profesionin inxhinier elektrik/inxhinier mekanik, me eksperience pune jo me pak se 1 (nje) vit ne kete profil". Ky operator duhet te qendroje i skualifikuar pasi ne kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe kriterin kualifikues te dokumentave te tenderit, pasi inxhinieri elektrik/mekanik nuk figurojne ne listepagesat e periudhes Shtator 2019 - Nentor 2019. Pasi referuar VKM nr. 514, date 20.9.2017 "Per miratimin e Listes Kombetare te Profesioneve (LKP)", te rishikuar., kodi nr 2144 "Inxhinier Mekanik" ose kodi nr. 2144.16 i cili referohet profesionit "Inxhinier Mekanik per ngrohje-ventilim-ftohje" profil ky qe perkon edhe me objektin e prokurimit, si dhe kodi 2151 "Inxhinieri elektrike", kode keto te cilat perkojne me kerkesat e autoritetit kontraktor ne dokumentat standarte te tenderit, kapaciteti teknik ku autoriteti kontraktor ka kerkuar 1 (nje) Inxhinier Mekanik dhe 1 (nje) Inxhinier Elektrik, ne si operateore ekonomik na lind e drejta te dyshojme se ne listepagesat e firmes Superior Klima Klima nuk figurojne inxhinieret e deklaruar prej saj pra ing Mekanik/Elektrik sipas kodeve perkatese te parashikuar ne VKM nr. 514, date 20.9.2017 "Per miratimin e Listes Kombetare te Profesioneve (LKP)", te rishikuar. Pra nga sa me siper ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentet per 1 (nje) Inxhinier Mekanik/Inxhinier Elektrik ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne DST. Kjo shoqeri nuk ka plotesuar kriterin kualifikues te DST, pasi nuk ka te siguruar ne listepagesat e periudhes Shtator 2019 - Nentor 2019 inxhinierin elektrik/mekanik

sipas VKM nr 514, date 20.09.2017 "Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP) e rishikuar", pasi kemi te bejme me nje kod specifik i cili i perket nje profesioni specifik dhe kesisoj nuk mund te pranohet kodi i nje profesioni tjetër per punonjesit e deklaruar. Edhe sikur pretendimi i operatorit ekonomik ne lidhje me padijenine ligjore ne lidhje me kete VKM jane te papranueshme, pasi njohja apo mosnjohja e ligjit eshte pergjegjesi individuale e subjekteve qe marrin pjese ne nje marredhenie juridike", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 4, të dokumentave të tenderit, është parashikuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik /inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

III.4.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Superior Klima Klima" sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë e shoqërisë në të cilin deklarohet emri i personit përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate ku thuhet se: "Unë i nënshkruari AM me cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik "Superior Klima" sh.p.k deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se AZ me profesion ing.Mekanik, Drejtues teknik pranë shoqërisë "Superior Klima" sh.p.k, me eksperiencë pune mbi 6 vite, do të jetë personi përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër."
- Licencën Profesionale të shoqërisë, në të cilën figuron si drejtues teknik AZ.
- Listpagesat e shoqërisë "Superior Klima" sh.p.k për periudhën shtator 2019-nëntor 2019, ku rezulton të jetë paguar AZ.
- Kontratën e punës nr.rep.77, nr.kol. 57, datë 11.01.2018 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë "Superior Klima" sh.p.k. dhe punëmarrësit AZ me profesion ing.Mekanik, për periudhë 5 vjecare.
- Diplonë e nivelit të parë në inxhinieri mekanike nga Universiteti Politeknik i Tiranës për AZ.
- Diplomë "Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike", profili Energjitike në emër të AZ, lëshuar në datë 17.12.2013 nga Universiteti Politeknik i Tiranës.
- CV e AZ
- Librezë pune e AZ ku ky i fundit rezulton i punësuar pranë shoqërisë "Superior Klima" sh.p.k që na data 24.03.2012.

III.4.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.4.1.4. Në nenin 28, pika 5, gërmat “b” e “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose[...].”*

III.4.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik /inxhinier mekanik, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, për operatorin ekonomik “Superior Klima” sh.p.k, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Superior Klima” sh.p.k në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm. Konkretisht, nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni konstatohet se, operatori ekonomik “Superior Klima” sh.p.k., ka deklaruar se AZ me profesion ing.Mekanik, Drejtues teknik pranë shoqërisë “Superior Klima” sh.p.k, me eksperiencë pune mbi 6 vite, do të jetë personi përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër dhe nga verifikimi rezulton se, ky i fundit, figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, dhe për të cilin është paraqitur dokumentacioni: diplomë në ing.mekanike, kontratë pune, librezë pune, CV dhe listpagesat e shoqërisë ku rezulton se drejtuesi teknik AZ figuron në këto listëpagesa.

Pra ky operator ekonomik plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në lidhje me personin përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin inxhinier elektrik /inxhinier mekanik.

Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “*Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese*” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4.2. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Altec” sh.p.k se: “*Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet ta skualifikoje operatorin ekonomik Superior Klima pasi ky operator ekonomik nuk ploteson kërkesën e dhënë në DST Shtojcën 4, Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, pasi nuk ka deklaruar se Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.2.1. Në shtojcën 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë :

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- *Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- *Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

III.4.2.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues ” Superior Klima ” shpk në përmbushje të shtojcës sa më sipër ka dorëzuar deklaratën me përmbajtje si më poshtë:

“Unë i nënshkruari AM me cilesinë e administratorit të operatorit ekonomik Superior Klima shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- *Operatori ekonomik Superior Klima shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- *Operatori ekonomik Superior Klima nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*
- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

EX

AM

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

- *Operatori ekonomik Superior Klima shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- *Operatori ekonomik Superior Klima shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik Superior Klima shpk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në fund të kësaj shtojce është deklaruar se:

“Në cdo rast autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.4.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.4.2.4. Referuar ekstraktit të regjistrit tregëtar të subjektit *Superior Klima* rezulton se kjo shoqëri në cilësinë e administratorit ka caktuar AM ndërsa në cilësinë e ortakëve të shoqërisë shfaqet EX.

III.4.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “*Superior Klima*” shpk ka dorëzuar shtojcën 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” si më sipër pasqyruar, nga ku rezulton se ka deklaruar administratorin e shoqërisë dhe ortakun e saj. Kjo deklaratë është plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të parashikuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në këtë shtojcë.

KPP gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e plotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese. Formatit i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve që plotësojnë cilësitë e përmendura më sipër dhe për këtë shkak shtojca 7 e dorëzuar nga operatori ekonomik “*Superior Klima*” shpk konsiderohet e rregullt pasi përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4.3. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “*Altec*” sh.p.k se: *“Gjithashtu ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën nga administratori i shoqërisë se cili nga inxh do të jete përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe deklaratën nga administratori i shoqërisë, se inxhinieret e mesipër, janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Dyshojmë se inxhinieret e deklaruar nga ky operator, janë të angazhuar edhe në procedura të tjera”,* Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se përse i përket argumentit të ankimuesit se nga ana e operatorit ekonomik “*Superior Klima*” shpk *“nuk është paraqitur deklarate nga administratori i shoqërisë se cili nga inxh do të jete përgjegjës për kryerjen e shërbimeve në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi”,* është trajtuar hollësisht të pikën III.4.1. të arsytimit si më sipër cituar, ndaj dhe pretendimi nuk qëndron.

Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik “Superior Klima” shpk “nuk ka paraqitur deklaratën nga administratori i shoqërisë, se inxhinieret e mesipër, janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Dyshojmë se inxhinieret e deklaruar nga ky operator, janë të angazhuar edhe në procedura të tjera”, nga verifikimi i kriterëve të vecanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit nuk rezulton të jetë parashikuar një kërkesë e tillë nga ana e autoritetit kontraktor, që të përbënte detyrim për tu plotësuar nga ana e subjekteve pjesëmarrëse në procedurë.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4.4. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Altec” sh.p.k se: *Gjithashtu ky operator ekonomik nuk disponon edhe Licensën profesionale për kategorinë NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, pika 1, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensë profesionale** që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:*

➤ *NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.*

➤ *NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.*

III.4.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Superior Klima” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë NZ.6810/6 për shoqërinë “Superior Klima” shpk, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe energjisë datë 10.07.2018, në të cilën rezulton, ndër të tjera, edhe kategoria NS-2, klasifikimi B “Impiante hidro sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre”.

III.4.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.4.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e*

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.4.4.5. Në nenin 26, pika 8, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, përcaktohet: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*

III.4.4.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë *Licencë NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Superior Klima” shpk rezulton se është dorëzuar Licencë NZ.6810/6 për shoqërinë “Superior Klima” shpk, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe energjisë datë 10.07.2018, në të cilën përfshihet edhe kategoria NS-2, klasifikimi B “*Impiante hidro sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre*”. KPP gjykon se Licenca që disponon operatori ekonomik “Superior Klima” shpk është në përputhje me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i shoqërisë “Altec” sh.p.k nuk qëndron.

III.4.5. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Altec” sh.p.k se operatori ekonomik “Superior Klima” shpk “*Nuk ka plotësuar deklaratën për paraqitje ofertes të pavarur, sipas Shtojcës 1/1 si dhe Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme shtojcën 7*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.5.1. Në shtojcën 1/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:

(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo

angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).



7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

III.4.5.2. Në shtojcën 7 Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;
- ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, **te leshuar jo me heret se 30 dite nga data e hapjes se ofertes.**

III.4.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese

III.4.5.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një

ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

III.4.5.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Superior Klima” shpk ka paraqitur shtojcën 1/1 me emërtim “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” sikundër kërkohet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.4.5.6. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për deklaratën për paraqitje ofertes të pavarur të operatorit ekonomik “Superior Klima” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4.5.7. Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik “Superior Klima” shpk “*Nuk ka plotësuar deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme shtojcën 7*”, Komisioni i Prokurimit Publik i qëndron të njëjtit gjykim të dhënë në pikën III.4.2 të arsyetimit të mësipërm, ndaj dhe pretendimi nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Sulollari-Klima” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr.REF-47078-01-06-2020, me objekt: “*Riparim mirëmbajtje sistemi të ngrohje-ftohjeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*” Loti I, me fond limit 17.383.344 lekë pa T.V.SH, zhvilluar në datën 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
2. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Altec” sh.p.k për operatorin ekonomik “Superior Klima” sh.p.k.

3. Autoriteti kontraktor të pasqyrojë në SPE vendimin e KSHA për kualifikimin e shoqërisë “Altec” sh.p.k.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 271 Protokolli;

Datë 04.03.2020

Nr. 283 Protokolli;

Datë 06.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha